 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-816/019	Data: Datum: 18.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Sistemi i digjitalizimit në SHFMU në Kaliqan", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-111-136, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Sistemi i digjitalizimit në SHFMU në Kaliqan", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-111-136 dhe në komision caktohen:


1. **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Kryesues i Komisionit;
2. **Hekuran Rugovaj**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe
3. **Sami Ferati**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsim, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Sistemi i digjitalizimit në SHFMU në Kaliqan" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-817/019	Data: Datum: 18.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Loto 1"Renovimi i depos dhe kalldatores në SHFMU "Bajram curri " në Cerrcë" dhe Loto 2"Rregullimi i infrastrukturës në oborrin e SHFMU "Trepça" në Banjë, me numer të brëndshëm prokurimi 633-019-105-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlersimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektet: Loto 1"Renovimi i depos dhe kalldatores në SHFMU "Bajram curri " në Cerrcë" dhe Loto 2"Rregullimi i infrastrukturës në oborrin e SHFMU "Trepça" në Banjë, me numer të brëndshëm prokurimi 633-019-105-521 dhe në komision caktohen:

1. **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Kryesues i Komisionit;
2. **Hekuran Rugovaj**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe
3. **Sami Ferati**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsim, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: Loto 1"Renovimi i depos dhe kalldatores në SHFMU "Bajram curri " në Cerrcë" dhe Loto 2"Rregullimi i infrastrukturës në oborrin e SHFMU "Trepça" në Banjë si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-818/019	Data: Datum: 18.11.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47 dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Istogut dhe “Hendikos” të datës 15.05.2019, shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-42988 të datës 19.09.2019 të parashtruar nga “Hendikos” nga Istogu, që ka të bëjë me përkrahje financiare pr realizimin e projekteve dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.01-400-42988 e datës 19.09.2019 e parashtruar nga “Hendikos”, për përkrahje financiare, dhe i ndahen 3,000.00€ (tremijë euro) nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, nga programi buxhetor i Kuvendit të Komunës, për përkrahje financiare për realizimin e projekteve për shërbimet e rehabilitimit të bazuara në bashkësi psiko sociale dhe Fizio-terapi për fëmijët me aftësi të veçanta.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e “Hendikos” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: “Hendikos”, Zyra e Kuvendit të Komunës dhe një kopje mbete në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-815/019	Data: Datum: 18.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Largimi dhe demolimi i objekteve të paperdorura", me numer të brëndshëm prokurimi 633-019-098/521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Largimi dhe demolimi i objekteve të paperdorura", me numer të brëndshëm prokurimi 633-019-098/521 dhe në komision caktohen:

- 1. Dukagjin Hoxhaj**, Zyrtar për Regjistrim të Adresave, Kryesues i Komisionit;
- 2. Hekuran Rugovaj**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe
- 3. Elfete Blakaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Largimi dhe demolimi i objekteve të paperdorura" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-814/019	Data: Datum: 18.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit, për formim të komisionit për pranimin e punëve për projektin: "Furnizimi dhe Montimi i serave tunnel" me Nr. prokurimi 633-019-009-R-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për pranimin e punëve për projektin: "Furnizimi dhe Montimi i serave tunnel" me Nr. prokurimi 633-019-009-R-121, të cilën e ka realizuat operatori "Adri Zaun-Rrethoja" SHPK nga Rahoveci dhe në komision caktohen:

1. **Valbone Kaliqani**, Zyrtare e Lartë për Pëmtari, Kryesuese e komisionit;
2. **Hasan Maxharraj**, Zyrtar i Lartë për Shpëztari, Bletari dhe Peshkatari, anëtar dhe
3. **Fisnik Shoshi**, Zyrtar Ligjor, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, operatori "Adri Zaun-Rrethoja" SHPK dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-811/019	Data: Datum: 18.11.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-50002 të datës 01.11.2019 të parashtruar nga Elton Bjamaj nga fsh. Banjicë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit,dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05-553-50002 e datës 01.11.2019, e parashtruar nga Elton Bajramaj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe i ndahen 150 € (njqind e pësdhjet euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2019, relacioni Banjicë-Prishtinë dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e babait Eltonë Bajramaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Elton Bajramaj, ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-50002 të datës 01.11.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit si nxënëse i rregulltë për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2019.

Eltoni e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnje burim të rregull të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi ti mbuloj shpenzimet e udhëtimit.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Elton Bjamaj, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorin për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Elton Bajramaj, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-822/019	Data: Datum: 19.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Paisja e klubeve sportive me rekuizita", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-104-121, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlersimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Paisja e klubeve sportive me rekuizita", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-104-121 dhe në komision caktohen:

1. **Driton Alihajdaraj**, Zyrtar i Prokurimit 2, Kryesues i Komisionit;
2. **Labinot Metaj**, OJQ "Sporti Shkollor" anëtar dhe
3. **Sami Ferati**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsim, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Paisja e klubeve sportive me rekuizita" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-819/019	Data: Datum: 19.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit, për formim të komisionit për pranimin e punëve për projektin: **"Blerja e Paisjeve Mjekësore Laboratorike për Nevoja të QKMF-së"**, me numer të brëndshëm prokurimi 633/019/062/121, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për pranimin e punëve për projektin: **"Blerja e Paisjeve Mjekësore Laboratorike për Nevoja të QKMF-së"**, me numer të brëndshëm prokurimi 633/019/062/121, të cilin e ka realizuar operatori **"ATOM-ED"** NTSH, Komuna-Ferizaj dhe në komision caktohen:
 1. **Dr.Tahir Kaliqanaj**, udh.i dep të Mjekësisë Familjare në QKMF, Kryesues i Komisionit;
 2. **Sevdije Shabanaj**, Motër Kryesore në QKMF, anëtare;
 3. **Aferdita Gjuraraj**, Laborante, anëtar.
2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket furnizimit të Paisjeve
3. ; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, operatori **"ATOM-ED"** NTSH, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-824/019	Data: Datum: 19.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika h). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe nenin 10. paragrafi 5 i Rregullores Komunale për punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr.2/2013, duke pasur parasysh nevojën për Plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, dhe në këtë komision caktohen:

1. Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryesues Komisioni;
2. Besart Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, anëtar;
3. Lulzim Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, anëtar;
4. Lulzim Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, anëtar;
5. Drin Sadikaj, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar;
6. Mujë Osmanaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
7. Hajrush Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
8. Demë Çetaj, Drejtor i Drejtorisë për Inspeksion, anëtar;
9. Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
10. Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodozi dhe Kadaster, anëtar;
11. Edona Bujupi-Loxha, Drejtoresh e Drejtorisë për Administratë, anëtare;
12. Zekije Sutaj, Udhëheqëse e Sektorit Ligjor, anëtare;
13. Muhamet Gusturanaj, Udhëheqës i Sektorit për Integritet Evropian, anëtar;
14. Selmon Blakaj, Udhëheqës i Sektorit të Gjendrës Civile, anëtar;
15. Osman Sadikaj, ZKF, anëtar;
16. Hazbi Bajra, Shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar.

1. Komisioni do të bëjë Plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin Projekt-Rregullores të cekur me lartë dhe pas përfundimit një kopje të Projekt-Rregullores do t'i dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij komisioni.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit.

3. Komisioni të fillojë me punë menjëherë, të gjitha punët juridike-administrative për nevojat të komisionit do t'i kryejë: Sektori Ligjor.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Komisioni dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor



Kryetari i Komunës

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-820/019	Data: Datum: 19.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: **"Furnizim më Paisje për Fikjen e Zjarrit në Objektet Shëndetësore"** prokurimi 633/019/116/136, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit me nr: 633/019/116/136 **"Furnizim më Paisje për Fikjen e Zjarrit në Objektet Shëndetësore"**, dhe në komision caktohen:
 1. **Haki Beli**, Insp. Për Mbrojtjen dhe Parandalimin kunder Zjarrit.Kryesues i Komisionit;
 2. **Brahim Hetemaj**, Udh. i sektorit për Shëndetësi, anëtare;
 3. **Fisnik Shoshaj**, Zyrtar Ligjor për Shëndetësi, anëtare.
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin **"Furnizim më Paisje për Fikjen e Zjarrit në Objektet Shëndetësore"**, si dhe do t'i kryej punët dhe përgjigjesit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni .
3. Vlersimin i ofertave do ta kryej Komisioni mbrenda tri ditëve të punes dhe për punën e kryer do ti raportoj Kryetarit të Komunes.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-823/019	Data: Datum: 19.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Dekorimi i qytetit me drita vezulluese për festat e fundvitit", me numer të brendshëm prokurimi 633-110-236, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Dekorimi i qytetit me drita vezulluese për festat e fundvitit" me numer të brendshëm prokurimi 633-110-236 dhe në komision caktohen:

1. **Bedri Hajzeraj**, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues i Komisionit;
2. **Qefsere Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare dhe
3. **Shefqet Imeraj**, Zyrtar Prokurimi 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Dekorimi i qytetit me drita vezulluese për festat e fundvitit" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-821/019	Data: Datum: 19.11.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-52158 të datës 15.11.2019 e parashtruar nga z.Agim Osmanaj, nga Fsh. Trubuhocë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e gruas së tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-52158 të datës 15.11.2019 e parashtruar nga z.Agim Osmanaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të gruas, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Agim Osmanaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Agim Osmanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-52158 të datës 15.11.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim të gruas Aferdita Osmanaj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Aferdita është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Agim Osmanaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Agim Osmanaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-832/019	Data: Datum: 20.11.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndertimi i kanalizimit në Lubozhdë-lagja Idrizaj", me numer të brëndshëm prokurimi 633-019-106-536, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlersimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Ndertimi i kanalizimit në Lubozhdë-lagja Idrizaj", me numer të brëndshëm prokurimi 633-019-106-536 dhe në komision caktohen:

1. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, Kryesues i Komisionit;
2. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar dhe
3. **Migjen Maxharraj**, Zyrtar për Promovim të Turizmit, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Ndertimi i kanalizimit në Lubozhdë-lagja Idrizaj" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


**Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA**


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-830/019	Data: Datum: 20.11.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenit 1 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-016-27310 të datës 01.07.2019 të parashtruar nga Ismet Haskaj nga Istogu, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për material ndertimor për shtëpi dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-016-27310 të datës 01.07.2019, e parashtruar nga Ismet Haskaj, për përkrahje financiare për material ndertimor për shtëpi dhe i ndahen 500.00€ (pesqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Ismet Haskaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ismet Haskaj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-016-27310 të datës 01.07.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për material ndertimor për shtëpi.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e lendes shihet se Ismeti e ka shtëpinë në gjendje jo të mirë dhe ka nevojë për blerjen e materialit për shtëpi dhe nuk ka kushte të mira për jetesën e familjes.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të blejë materialin për shtëpi.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është i përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Ismet Haskaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-826/019	Data: Datum: 20.11.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenit 1 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi, shqyrtoi kërkesën Nr.09-553-77221, të datës 04.12.2019, të parashtruar nga Shefqet Rugovaj, nga fsh. Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga semundja që i ka ngordhur lopa me viq dhe i propozoj Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-553-77221, të datës 04.12.2019, të parashtruar nga Shefqet Rugovaj, për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga semundja që i ka ngordhur lopa me viq, dhe i ndahen 600.00€ (gjashtëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e bashkëshortës Shefqet Rugovaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shefqet Rugovaj, ka parashtruar kërkesën Nr.09-553-77221, të datës 04.12.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga semundja që i ka ngordhur lopa me viq. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron te arsyeshme dhe e miraton. Komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes ka vlerësuar dëmin e shkaktuar dhe ka dal me vlerësimin e dëmit në shumë prej 1,200.00€(njëmijë e dyqind euro), por në mungesë të mjeteve financiare perkrahet në shumë prej 600.00€ (gjashtëqind euro).

Nga shkresat e lendes shihet se Shefqetit i ka ngordhur lopa me viq që prej saj ka siguruar të ardhura për ushqimin e familjes.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të blejë lopen dhe viqin, i cili në të ardhmen ka menduar të rrisë numrin e lopëve.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Shefqet Rugovaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-825/019	Data: Datum: 20.11.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenit 1 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi, shqyrtoi kërkesën Nr.09-320-3512 të datës 28.01.2019, të parashtruar nga Emin Blakaj, nga fsh. Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga semundja që i ka ngordhur lopa dhe i propozoj Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-3512 të datës 28.01.2019, të parashtruar nga Emin Blakaj, për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga semundja që i ka ngordhur lopa, dhe i ndahen 500.00€ (pesqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e bashkëshortës Merlinda Blakaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Emin Blakaj, ka parashtruar kërkesën Nr.09-320-3512 të datës 28.01.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e ngordhjes së lopes.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e lendes shihet se Emini i ka ngordhur lopa që prej saj ka siguruar të ardhura për familje.

Komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes ka vlerësuar dëmin e shkaktuar dhe ka dal me vlerësimin e dëmit në shumë prej 1,000.00€(njëmijë euro), por në mungesë të mjeteve financiare perkrahjet në shumë prej 600.00€ (gjashtëqind euro).

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të blejë lopen.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e bashkëshortës Merlinda Blakaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Emin Blakaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-831/019	Data: Datum: 20.11.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, Komisioni për vlerësim i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-553-7689 të datës 25.02.2019 të parashtruar nga Niman Çapkunaj nga Istogu, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për ndërtimin e pullazit-kulmit të shtëpisë dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-553-7689 të datës 25.02.2019, e parashtruar nga Niman Çapkunaj, për përkrahje financiare për ndërtimin e pullazit-kulmit të shtëpisë dhe i ndahen 2,500.00€ (dymijë e pesqind euro) nga burimi i financimit 22-të hyrat vetanake të bartura nga vitet e kaluara nga kategoria ekonomike subvencione dhe tranfere programi-nenprogrami 180-17 i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Niman Çapkunaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Niman Çapkunaj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-553-7689 të datës 25.02.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për ndërtimin e pullazit-kulmit të shtëpisë.

